




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË SKËNDERAJT PËR VITIN 2021

Prishtinë, qershor 2022

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Skënderajt për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Skënderajt (SK), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Skënderajt, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Skënderajt kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Komuna kishte angazhuar 16 punonjës me marrëveshje për shërbime të veçanta pa zhvilluar procedura të prokurimit. Këto pozita ishin kryesisht për pozita të rregullta të punës, si: specialist i mjekësisë, pediatër dhe staf shëndetësor.
- A2 Gjatë trajtimit të detyrimeve të papaguara kemi vërejtur se katër pagesa në vlerë prej 78,002€ nuk ishin raportuar në raportet mujore të obligimeve të papaguara, dhe kishte vonesa në pagesa nga 49 ditë deri në 137 ditë.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Skënderajt.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Skënderajt është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Skënderajt në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Skënderajt me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Skënderajt.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur se Sistemi i kontrollit të brendshëm në Komunën e Skenderajt në disa fusha nuk është në nivelin e duhur. Fushat për përmirësim janë si: kontrollet e brendshme në procesin e hartimit të PVF-ve, mangësi në menaxhimin e shpenzimeve, angazhimi i të punësuarve përmes kontratave për shërbime të veçanta, menaxhimi i projekteve kapitale, menaxhimi i pasurive jo financiare, llogarive të arkëtushme detyrimeve dhe mos kompletimi i NJAB-së, të cilat janë paraqitur më poshtë në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 11 rekomandime, prej tyre shtatë (7) janë rekomandime të reja, dy (2) të përsëritura dhe dy (2) pjesërisht të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Angazhimi i stafit me marrëveshje për shërbime të veçanta jo në përputhje me ligjin

Gjetja Sipas nenit 84 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtar Publik përcakton Marrëveshjet për shërbime të veçanta, lidhen sipas legjislacionit përkatës të prokurimit publik ku, sipas paragrafit 4 të ndryshim plotësimit të rregullave për prokurim të shërbimeve të veçanta (konsulent/kontraktorët individual) këto rregulla aplikohen vetëm për prokurimin e shërbimeve të veçanta të cilat nuk mund të sigurohen përmes procedurave të rekrutimit. Marrëveshjet për shërbimet e veçanta lidhen sipas legjislacionit përkatës të prokurimit publik.

Komuna kishte angazhuar 16 punonjës me marrëveshje për shërbime të veçanta pa zhvilluar procedura të prokurimit. Nga testimi i katër (4) mostrave, rezulton se këto pozita ishin kryesisht për pozita të rregullta të punës, si: specialist i mjekësisë, pediatër dhe staf shëndetësor.

Një dukuri e tillë sipas menaxherit të personelit ka ndodhur për shkak të nevojës së mëtejme për angazhimin e stafit për realizimin e objektivave shtesë të komunës gjatë periudhës me pandemi.

Ndikimi Mos respektimi i kërkesave ligjore për angazhim të stafit ndikon/kufizon konkurrencën si dhe meritokracinë e po ashtu dhe ndikim edhe në performancë të dobët të organizatës.

Rekomandimi A1 Kryetari, duhet të sigurojë se që nevojat e komunës për pozitat të rregullta të adresohen në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve dhe aty ku është e nevojshme angazhimi i stafit me marrëveshje të veçanta, të respektohen kërkesat ligjore në fuqi.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Raporti i obligimeve të papaguara jo i plote

Gjetja Rregulla Financiare Nr. 02/2013 - MF për raportimin e obligimeve të papaguara të organizatave buxhetore, neni 5 - Raportimi i obligimeve të papaguara parasheh që, të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara që në Ministrinë e Financave - Thesar të raportojnë obligimet e tyre të papaguara. Raportimi, bëhet përmes raporteve mujore. Raporti mujor i obligimeve të papaguara duhet të përfshijë gjendjen e obligimeve të periudhës raportuese, përfshirë këtu të gjitha obligimet, pa marrë parasysh se në cilën periudhë kanë ndodhur.

Gjatë trajtimit të detyrimeve të papaguara kemi vërejtur se katër pagesa nuk ishin raportuar në raportet mujore të obligimeve të papaguara:

- fatura në vlerë 9,100€ e paguar në mars nuk ishte prezantuar në raportin e muajit shkurt;

- fatura në vlerë 1,739€ e paguar në muajin shkurt nuk ishte prezantuar në raportin e muajit janar;

- fatura në vlerë 1,182€ e paguar në shkurt nuk ishte prezantuar në raportin e muajit janar; dhe

- fatura në vlerë 65,981€ e paguar në maj nuk ishte raportuar në muajin prill.

Të gjitha këto pagesa nuk ishin paguar brenda afatit 30 ditor dhe kishin vonesa nga 49 ditë deri në 137 ditë.

Shkak i mos pagesës me kohë të detyrimeve është planifikimi jo i mirë i alokimit/zotimit të mjeteve dhe inicimi i procedurave të shpenzimeve pa mjete në dispozicion. Ndërsa mos raportimi i tyre në raportet mujore të obligimeve ishte për shkak të kontrolleve të brendshme jo të mjaftueshme.

Ndikimi

Detyrimet e bartura rrisin rrezikun në realizimin e projekteve dhe në arritjen e objektivave të komunës. Si rezultat i nevojës për t'i paguar (obligimet) zotimet e viteve paraprake, njëherit kjo ndikon edhe në kosto shtesë në rast të padive nga furnitorët.

Rekomandimi A2

Kryetari duhet të sigurojë një planifikim më të mirë të alokimit dhe zotimit të mjeteve si dhe inicimi i procedurave të shpenzimeve të realizohet vetëm kur mjetet janë në dispozicion me qëllim të pagesës së detyrimeve ndaj operatorëve ekonomik. Po ashtu raportet mujore të obligimeve të rishikohen për qëllimin e plotësisë para se të dorëzohen në Thesar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Kontrollat e brendshme në raportimin financiar

Në vijim janë çështjet që kanë të bëjnë me prezantimin e të dhënave dhe përgatitjen në Pasqyra Financiare.

Çështja A3 - Korrigjimi i Pasqyrave Financiare Vjetore

Gjetja

Përgatitja e PVF-ve duhet të bazohet sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik dhe “Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme si dhe sipas Rregullores së MFTP nr. 01/2017 për Raportimin vjetor financiar të organizatës buxhetore.

Komuna ka përgatitur dhe dërguar në Thesar PVF sipas afatit të paraparë deri më 30 Janar. Megjithatë, me rastin e rishikimit të PVF, nga ana e auditimit, janë vërejtur disa çështje të cilat ju kanë rekomanduar komunës për korigjim. Çështjet të cilat janë identifikuar ishin:

- Te neni 13 - Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme - burimi i fondeve pranimet, nuk ishin prezantuar kthimi i depozitave në shumë 100,000€ si dalje e fondeve;
- Te neni 14 Raporti i ekzekutimit të buxhetit - hyrja e paras në LLVTH në kolonën realizimi, ishte prezantim i pasaktë i të hyrave nga donacionet në shumë 131,000€, duhej të prezantohen në shumën 227,000€;
- Po ashtu, prezantimi i pranimeve nga depozitat, në shumë 140,000€ dhe shënimet shpjeguese nuk ishin prezantuar në vlera të sakta dhe të plota.

Pas identifikimit të gabimeve dhe këshillave nga auditimit, Komuna kishte ndërmarre veprime dhe kishte bërë korrigjimet e nevojshme dhe versioni i korrigjuar i PVF-ve ishte përgatitur sipas kërkesave të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik “Raportimi financiar sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme”, dhe i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga korniza ligjore për raportim

Kjo kishte ndodhur për shkak të kontrolleve të brendshme jo adekuate dhe njohurive të mangëta të stafit përgjegjës në përgatitjen e PVF-ve, sa i përket prezantimit të depozitave.

Ndikimi

Mos prezantimi i saktë dhe i plotë i informatave financiare dhe jo financiare në PVF, nuk paraqet një pamje të vërtetë dhe të saktë të të dhënave dhe ulë shkallën e besueshmërisë tek përdoruesit e synuar.

Rekomandimi A3

Kryetari duhet të shtoj kontrollat gjatë hartimit të PVF-ve, në mënyrë që PVF-të për vitin 2022 të mos përmbajnë gabime kontabël dhe administrative. Deklarata e dhënë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar duhet të nënshkruaj vetem pasi që janë siguruar se PVF-të prezantojnë të dhëna të plota dhe të sakta.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe komunalitë në vitin 2021 ishte 1,757,726€, prej tyre ishin shpenzuar 1,701,383€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shpenzimet komunale, shpenzimet e derivateve dhe lëndët tjera për ngrohje, mirëmbajtje të objekteve, shpenzime kontraktuese tjera, etj.

Çështja A4 - Keq klasifikimi i shpenzimeve

Gjetja Sipas nenit 18, pika 3 e rregullores 01/2013 - MF për Shpenzimin e Parasë Publike, shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Në planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Pagesa në vlerë prej 23,150€ për furnizim me 1,000 pako ushqimore për familjet me nevoja, është bërë nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime, derisa natyra e shpenzimeve i përket kategorisë për subvencione dhe transfere. Çështja e keqklasifikimit të shpenzimeve, ka qenë e theksuar edhe në raportin e auditimit për vitin 2020.

Zyrtarët përgjegjës komunal janë shprehur se nuk kanë qenë në dijeni se si ta klasifikojnë këtë llojë shpenzimi.

Ndikimi Pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve në kode ekonomike jo adekuate, ndikon në prezantimin e shpalosjeve jo të sakta të këtyre shpenzimeve sipas kategorive ekonomike duke mbi/nënvlerësuar njërin dhe tjetrën kategori ekonomike të shpenzimeve.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të sigurojë vendosjen e sistemit të kontrolleve të brendshme në këtë fushë, procedimi dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve dhe kategorive ekonomike adekuate në përputhje me planin kontabël të miratuar nga Thesari.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.3 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 3,896,457€, prej tyre në 2021 ishin shpenzuar 3,319,291€. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin e kanalizimeve, rrugëve, ujësjellësve, objekte kulturore, mirmbajtje investive, pajisje mjeksore, etj.

Çështja A5 - Vonesa në ekzekutimin e punëve

Gjetja

Neni 2 i kontratës thotë: çmimi total i punëve duhet të jetë 1,159,800€. Mjetet për pagese për vitin 2016 janë 30,000€, parashikimet buxhetore për vitin 2017 janë 160,000€, ndërsa mjetet tjera për pagese për vitin 2018 janë paraparë 300,000€ dhe për vitin 2019 janë paraparë 669,800€.

Kontrata për “Ndërtimin e kanalizimit në fshatin Klinë-Kuqicë në gjatësi 49,400m Komuna Skenderaj”, ishte nënshkruar me 11.10.2016 dhe duhet të përfundonte brenda tri viteve (gjatë vitit 2017, 2018 dhe 2019) por ky projekt ende nuk është realizuar në tërësi. Derisa më 07.05.2021 ishte realizuar edhe pagesa e situacionit të 25 në shumë prej 65,981€. Komuna kishte marr vendimet për zgjatjen e afatit të kontratës me qëllim të realizimit të saj.

Këto vonesa ishin për shkak të hyrjes në kontratë para se me i ndarë mjetet e nevojshme buxhetore dhe për shkak të pengesave të ndryshme në terren të paraqitura nga komuniteti gjatë realizimit të projektit.

Ndikimi

Vonesat e gjata në realizimin e projekteve e zvogëlojnë vlerën e tyre dhe mos përmbushja e kushteve të kontratës mund të krijojë efekte shtesë me ndikim në buxhetin e komunës.

Rekomandimi A5

Kryetari duhet të sigurojë se me qëllim të realizimit me kohë të projekteve kapitale, paraprakisht të jenë siguruar fondet për realizimin e projektit dhe ka ndermarrë të gjitha masat për evitimin e pengesave në zbatim të kontratës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.4 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 150,211,544€, pasurive jokapitale është 42,380€, si dhe e stoqeve 75,784€.

Çështja A6 - Dobësi në menaxhimin e pasurive

Gjetja

Rregullore MF - nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, përcakton procedurat standarde për dokumentimin, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jofinanciare, mbajtjen e saktë të të dhënave mbi pasurinë jo financiare përmes mirëmbajtjes sistematike të regjistrit të pasurive jo financiare kapitale.

Pasuritë jo financiare kapitale mbi 1,000€ në raportin vjetor financiar janë prezantuar me vlerë 150,544,842€, ndersa sipas auditimit vlera e pasurive është 151,336,285€, pra një nënvlerësim në PVF për 791,443€, këtë e ka ndikuar pjesa e pa regjistruar e objektit shkollor “Gjimnazi Hamëz Jashari në Skenderaj” në vlerë 1,849,903€ i financuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), në regjistrin kontabel të SIMFK-së për Skenderaj, ishte regjistruar një pjesë e saj, respektivisht vlera 1,058,460€. Ndërsa vlera tjetër nuk ishte e regjistruar në SIMFK të komunës së Skenderajt, megjithëse shkolla ishte në përdorim nga shtatori i vitit 2021.

- “Objekti sportiv Poligoni Multifunksional” në vlerë 193,722€ ishte regjistruar si pasuri, pasi që ishte bërë pranimi teknik për pjesën e punëve të kryera për fazën e dytë edhe pse projekti ende nuk është i përfunduar. Për këtë objekt është kalkuluar zhvlerësimi në vlerë prej 5,650€. Në këtë rast, kjo pasuri ishte e nënvlerësuar për vlerën e zhvlerësimit pasi që duhet të ishte si pasuri - investime në vijim. Për më tepër komuna për ndërtimin e këtij projekti nuk kishte aplikuar për leje të ndërtimit, andaj konsiderohet si ndërtim pa leje.

- “Softueri për kontabilitet në komunën e Skenderajt” në vlerë 4,250€ ishte regjistruar me jetëgjatësi 7 vite dhe do të duhet të regjistrohej si pasuri e paprekshme - 10 vite, kjo ka ndikuar në vlerën e tij të mbetur në libra që të jetë e nënvlerësuar, për 910€ për këtë pasuri.

Dobësitë e paraqitura janë si shkak i mos funksionimit të duhur të kontrolleve të brendshme në menaxhimin e pasurive duke përfshirë këtu edhe mos rishikimin e gjendjes së pasurisë.

Ndikimi

Kjo ka ndikuar në vlerat e tyre neto në librat e pasurive dhe rrjedhimisht në vlerën neto të pasurive të prezantuara në pasqyrat financiare vjetore.

Rekomandimi A6

Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme në menaxhimin e pasurive dhe të bëjë një rishikim dhe të siguroj regjistrimin e plotë dhe të saktë të pasurisë në regjistrat kontabel, dhe të bëjë një rivlerësim të të gjithë listës së pasurive të komunës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Mangësi në Inventarizimin e pasurisë jo financiare**Gjetja**

Sipas Rregullores MF - nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në Organizatat buxhetore, neni 18 përcakton se çdo vit duhet të bëhet inventarizimi i të gjitha pasurive në pronësi dhe kontroll të organizatës buxhetore, verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes, krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare, identifikimi i pasurive që nuk kanë vlerë të bartur, si dhe pasuritë e dëmtuara dhe jashtë përdorimit. Sipas nenit 6.3 pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin “e-pasuria”.

Kryetari i komunës kishte caktuar tri komisione për inventarizimin e pasurive sipas sektorëve (shëndetësi dhe mirëqenie, administratë, dhe arsim) të cilët duhej të dorëzonin raportet e tyre deri me datën 25.12.2021. Komuna ka ofruar vetëm raportin e inventarizimit të pasurive për sektorin e Administratës, ndërsa për dy sektorët tjerë nuk kishin të përfunduar raportin e inventarizimit të pasurive jo financiare. Raporti i inventarizimit për sektorin e Administratës përveç që ishte bërë me vonesë respektivisht me datën 16.02.2022, po ashtu raporti nuk i përmbante kërkesat sipas detyrave të caktuara në vendim, rrjedhimisht nuk ishte bërë krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare.

Po ashtu sistemi “e-pasuria” për regjistrimin e pasurisë jo kapitale (me vlerë nën 1,000€) kishin probleme dhe mangësi, për shkak të mos funksionimit të tij në nivelin qendrorë.

Kjo kishte ndodhure për shkak të mungesës së mjaftueshme të kontrolleve të brendshme ndaj menaxhimit të pasurive jo financiare.

Ndikimi

Mos inventarizimi i plotë i pasurive jo financiare dhe mos krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen e regjistrave të pasurive dhe mos vlerësimi i pasurive, pamundëson marrjen e sigurisë lidhur me saktësinë dhe plotësinë e regjistrave dhe vlerës së pasurisë.

Rekomandimi B1

Kryetari, duhet të sigurojë se procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive të kryhet në të gjithë sektorët dhe komisionet duhet të bëjnë krahasimin e rezultateve të inventarizimit me gjendjen kontabël të pasurive, duke i verifikuar të gjitha pasuritë sipas gjendjes me vlerë, në përdorim dhe jashtë përdorimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.5 Të arkëtueshmet

Skenderaj në PFV e vitit 2020 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 1,368,871€. Kjo vlerë përbëhet nga të arkëtueshmet e tatimit në pronë, taksa në biznes, shfrytëzimi i pronës publike (renta dhe qiraja) si dhe lejet ndërtimore.

Çështja C1 - Dobësi në menaxhimin e Llogarive të Arketueshme

- Gjetja** Arkëtimi i të hyrave bëhet sipas afateve kohore të përcaktuara në faturë për secilin lloj të të hyrave.
- Pjesa më e madhe e llogarive të arketueshme i takon tatimit në pronë në vlerë 993,516€ rreth 73%, taksa komunale në biznes në vlerë 243,169€ rreth 18%, dhe shfrytëzimi i pronës publike (renta dhe qiraja) në vlerë 132,185€ rreth 10%. Komuna nuk kishte menaxhim efektiv në mbledhjen e të arkëtueshmeve pasi që vazhdon rritja e tyre vit pas viti. Në krahasim me vitin paraprak rritja ishte 191,525€ respektivisht rreth 16.3%.
- Rritja e llogarive të arkëtueshme ishte për shkak të kontrolleve të brendshme jo efektive në menaxhimin dhe inkasimin e tatimeve dhe taksave komunale.
- Ndikimi** Mos arkëtimi në kohë i të hyrave të ngarkuara ndikon në nivelin e fondeve të mbledhura për buxhetin komunal dhe rrjedhimisht ndikon në financimin dhe realizimin e projekteve nga të hyrat vetjake.
- Rekomandimi C1** Kryetari duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme duke hartuar dhe aplikuar plane dhe procedura të qarta për mënyrën e arkëtimin të tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.6 Detyrimet kontigjente

Pasqyra e detyrimeve kontigjente në fund të vitit 2021, ishte 978,994€. Nga kjo vlerë ishin: 389,649€ për konteste për pagesen e pagave, jubileve, shujtave dhe rikthimit në punë, 568,147€ për konteste civile, kompenzim dëmi, dhe 21,197€ ishin për konteste të borxheve ndaj faturave të operatorëve ekonomik.

Çështja B2 - Mangësi në listën e detyrimeve kontigjente

Gjetja

Lista e detyrimeve kontigjente duhet të jetë e bazuar mbi dëshmitë burimore që dëshmojnë vlerën e detyrimeve të pretenduara nga palët në procedure kontestimore dhe se ato kanë të bëjnë me komunën.

Nga shtatë (7) mostrat e kërkuara për auditimin e detyrimeve kontigjente, në kemi pranuar katër prej tyre, ndërsa tri tjerat, zyrtarët komunal nuk ishin në gjendje që t'i siguronin, për arsye të ndërrimit të zyrtarëve përgjegjës dhe të lëvizjes së dokumenteve nga objekti i vjetër në atë të ri.

Lista e detyrimeve kontigjente kishte 386 raste të kontestive me vlerën e pretendimeve të tyre fillestare të paraqitura në padi 978,994€ (të cilat nuk përfshijnë shpenzimet procedurale dhe kamatat ligjore). Në këtë listë ka raste të cilat janë paraqitë si konteste që nga vitet 2005, 2006 e deri në ditën e raportimit (me 31.12.2021), por në mesin e kësaj liste kemi identifikuar dy raste të cilat tanimë janë të zgjidhura dhe që nuk duhej të ishin në këtë listë.

Mungesa e përditësimit të listës së detyrimeve kontigjente, krijon paqartësi për numrin dhe vlerën e rasteve kontestuese për komunën që lidhen me pretendimet e palëve tjera ndaj detyrimeve komunale. Po ashtu, ndikon në mbivlerësimin apo nënvlerësimin e vlerës së tyre të prezantuara në PVF.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos përditësimit të listës së detyrimeve kontigjente dhe mungesës së kapaciteteve në zyrën e avokatit të komunës.

Ndikimi

Mungesa e përditësimit të listës së detyrimeve kontigjente, krijon paqartësi për numrin dhe vlerën e rasteve kontestuese për komunën që lidhen me pretendimet e palëve tjera ndaj detyrimeve komunale.

Rekomandimi B2

Kryetari duhet të sigurojë se lista e detyrimeve kontigjente duhet të jetë e bazuar mbi dëshmitë përkatëse dhe të sakta, dhe që përditësohet në periudha të rregullta, në mënyrë që të dëshmojnë vlerën financiare dhe të siguroj pretendimet e tilla që kanë të bëjnë me komunën.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.7 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) kishte vetëm një anëtarë. NjAB kishte plan strategjik dhe plan vjetor nga i cili kishte realizuar tri prej shtatë auditimeve të planifikuara, përderisa periudha e mbuluar me auditim ishte kryesisht viti 2021. Komiteti i auditimit nuk ishte funksional gjatë vitit 2021 deri me 8 dhjetor kur ishte themeluar dhe kishte mbajtur vetëm një takim, ku kishte miratuar planin strategjik të auditimit të brendshëm për vitin 2022-2024, miratimin e planit vjetor të NjAB për vitin 2022.

Çështja B3 - Mos kompletimi i NjAB-së

Gjetja Rregullore QRK - nr. 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të Auditimit të Brendshëm në subjektin e sektorit publik, Neni 5.1.1 përcakton që, subjekti i sektorit publik me buxhet mbi shtatë (7) milion euro të ketë së paku tre (3) auditorë të brendshëm, dhe komuna e plotëson këtë kriter.

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) kishte vetëm një Auditor të brendshëm. Udhëheqësi i NjAB-së kishte dhënë dorëheqje nga marrëdhënia e punës në korrik 2021. NjAB kishte hartuar planin strategjik, planin vjetor të punës ku ishin përfshirë shtatë (7) auditime. Prej tyre, vetëm tri (3) auditime ishin përfunduar për shkak të ndikimit të pandemisë Covid 19 dhe stafit të pamjaftueshëm të NjAB-së. Auditimet ishin fokusuar në fushën e prokurimit, pasurive dhe menaxhimit të tyre si dhe në fushën e të hyrave. Komuna kishte bërë përpjekje për të angazhuar Auditorin e Brendshëm dhe Udhëheqësin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm, por nuk kishte arritur me procedura të brendshme për shkak të mungesës së kandidatëve të kualifikuar sipas kërkesave për këto pozita, dhe tani është në procedurë me konkurs të jashtëm.

Ndikimi Mos kompletimi i NjAB me staf të mjaftueshëm dhe mos realizimi i planit, ndikojnë që auditimi i brendshëm mos të mbulojë të gjitha fushat me rrezik, dhe t'i pamundësoj menaxhmentit marrjen e veprimeve me kohë për parandalimin e gabimeve të mundshme.

Rekomandimi B3 Kryetari, duhet të sigurojë që pozitat e zbrazëta në NjAB të plotësohen sa me herët të jetë e mundshme, që do të ndikonin në funksionimin dhe forcimin e kontroleve të brendshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A7 - Komiteti i auditimit jo funksional

Gjetja UA MF-Nr. 01/ 2019 për themelimin dhe funksionimin e komitetit të auditimit në subjektin e sektorit publik, neni 4 themelimi i komitetit të auditimit, paragrafi 1. Çdo subjekt i sektorit publik që ka të themeluar Njësine e auditimit të brendshëm në nivel të organit kryesor sipas legjislacionit në fuqi, themelon Komitetin e Auditimit.

Komuna e Skenderajt ishte pa komitet të auditimit gjatë vitit 2021 deri me 08.12.2021 kur kryetari kishte themeluar komitetin. Ky komitet kishte mbajtur një takim, i cili kishte miratuar, planin strategjik të auditimit të

brendshëm për vitin 2022-2024, planin vjetor të NjAB-së për vitin 2022, kishte diskutuar raportin e gjashtëmujorit të dytë dhe atë vjetor 2021.

Kjo kishte ndodhë për shkak të mos dhënies së rëndësisë së duhur nga menaxhmenti i komunës.

Ndikimi

Mos funksionimi i komitetit të auditimit ndikon që auditimi i brendshëm të mos i japë rezultatet e punës se vet në përforcimin e kontrolleve të brendshme në organizatë buxhetore.

Rekomandimi A7

Kryetari duhet të sigurojë që komiteti i auditimit të jetë funksional, që t'i ndihmon në përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike, me qëllim që të arrihen objektivat e synuara të organizatës, duke ofruar këshilla dhe rekomandime që kanë të bëjnë me qeverisjen, menaxhimin e rrezikut dhe proceset e kontrollit të brendshëm.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁴	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Burimet e fondeve	14,207,588	14,777,943	14,057,504	14,158,325	13,507,214
Grante Qeveritare - Buxheti	12,686,085	12,641,007	12,485,548	12,789,981	11,536,240
Financimi përmes huamarrjes	0	63,567	63,496	136,390	91,527
Të bartura nga viti i kaluar	0	313,814	313,788	561,316	586,075
Të hyrat vetanake	1,521,503	1,521,503	1,063,816	643,748	1,151,988
Donacionet vendore	0	9,012	1,242	0	0
Donacionet e jashtme	0	229,041	129,615	26,890	141,385

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 570,355€. Kjo rritje është rezultat i rritjes së kategorisë së pagave 209,000€ për kompensimin e shtesave, si rezultat i angazhimeve shtesë gjatë Covid 19, për punëtorët shëndetësor, për shtesat e stafit arsimor, për punëtor teknik, për stafin në shërbime sociale dhe për zjarrfikësit.

Në vitin 2021, OB ka shpenzuar 95% të buxhetit përfundimtar ose 14,057,504€, me një përmirësim 7% në krahasim me vitin 2020. Sidoqoftë, zbatimi i buxhetit mbetet në një nivel të kënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	14,207,588	14,777,943	14,057,504	14,158,325	13,507,214
Pagat dhe mëditjet	8,132,003	8,314,213	8,301,053	8,117,827	7,687,208
Mallrat dhe shërbimet	1,561,786	1,546,845	1,499,467	2,398,184	1,564,420
Komunalitë	230,381	210,881	201,916	183,022	183,249
Subvencionet dhe transferet	635,000	809,547	735,777	573,595	552,047
Investimet Kapitale	3,031,561	3,896,457	3,319,291	2,885,696	3,520,290
Rezervat	616,857	0	0	0	0

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Kategoria e pagave në buxhetin final kishte një rritje për 182,210€ krahasuar me buxhetin fillestar dhe një realizim prej 99.84%.
- Kategoria mallra dhe shërbime në fund të vitit kishte zvogëlim të buxhetit për 14,941€ dhe ishte realizuar rreth 97%.
- Kategoria e komunalive në fund të vitit kishte zvogëlim të buxhetit për 19,500€ dhe ishte realizuar rreth 96%.
- Kategoria subvencioneve dhe transfereve, në fund të vitit kishte rritje të buxhetit për 174,547€ dhe ishte realizuar rreth 91%.
- Kategoria investime kapitale në fund të vitit, kishte rritje të buxhetit për 864,896€, kjo rritje ishte për 616,857€ që ishin transferuar nga rezervat që ishin për investime kapitale, nga të hyrat vetijake për 303,000€, nga donacionet për 235,000€ dhe kishte zvogëlime në vlerë prej 289,961€ sipas vendimeve të bazuara në kërkesat e Ligjit të menaxhimit të financave publike dhe përgjegjësi, dhe në fund të vitit ishte realizuar në vlerë 3,319,291€ apo rreth 85%.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



Të hyrat e planifikuara për vitin 2021 ishin në vlerë 1,521,503€, ndërsa ishin realizuar 1,261,294€, apo rreth 83%. Ato kanë të bëjnë me 282,731€ për të hyrat tatimore dhe 978,563€ për të hyrat jo tatimore.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
Totali i të hyrave	1,521,503	1,521,503	1,261,294	660,933	1,548,530
Të hyrat tatimore	253,639	253,639	282,731	189,768	272,870
Të hyrat jo tatimore	1,267,864	1,267,864	978,563	470,340	1,275,660
Të hyrat tjera	0	0		826	

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2020 të Skenderajt, ka rezultuar në 7 rekomandime. Komuna e kishte diskutuar këtë raport në asamblenë komunale dhe kishte përgatitur një plan veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2021, tre (3) rekomandime janë zbatuar; një (1) ishte në proces; dhe tri (3) nuk ishin adresuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari të siguroj se gjatë përgatitjes se kontratave publike kornizë të planifikohen dhe të definoohen drejtë sasitë për pozicione dhe çmimet e kontratave, në mënyrë që mospërputhjet eventuale mos të tejkalojnë limitin e lejuar plus/minus tridhjetë përqind (30%).	Nuk kemi identifikuar raste të tilla gjatë vitit 2021.	I zbatuar
2.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari të sigurojë ndarjen e drejtë të detyrave në procesin e menaxhimit të aktiviteteve të prokurimit dhe kontratave konform respektimit të kritereve ligjore dhe rregullative të prokurimit publik.	Nuk kemi evidentuar raste të tilla gjatë vitit 2021.	I zbatuar
3.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari, duhet t'i forcojë kontrollet mbi menaxhimin e subvencioneve dhe të sigurojë që subvencionet ndahen në përputhje me kriteret e vendosura në thirrje publike.	Nuk kemi evidentuar raste të tilla gjatë vitit 2021.	I zbatuar
4.	Pasuritë	Kryetari, duhet siguruar se procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive do të kryhet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, si dhe më pas, të bëhet krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen kontabël të pasurive, duke i sqaruar të gjitha diferencat.	Edhe gjatë vitit 2021 kemi evidentuar mangësi në procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive jo financiare.	Nuk ka filluar zbatimin
5.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari, duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme. Hartimi dhe aplikimi i programeve dhe procedurave të qarta për mënyrën e menaxhimit, regjistrimit dhe arkëtimit të tyre, do të ishin disa nga masat që mund të sjellin përmirësime.	Gjatë vitit komuna kishte arrit që t'i përfshij në listën e të arkëtueshmeve edhe të arkëtueshmet nga tatimi në parcela, por trendi i rritjes mbetet edhe me i lartë.	Pjesërisht i zbatuar
6.	Detyrimet Kontingjente	Kryetari duhet të sigurojë se lista e detyrimeve kontingjente duhet të jetë e bazuar mbi dëshmitë përkatëse dhe të sakta, në mënyrë që dëshmojnë vlerën financiare dhe të sigurojë pretendimet e tilla kanë të bëjnë me komunën.	Edhe këtë vit gjendja është e njëjtë me vitin paraprak.	Nuk ka filluar zbatimin
7.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari, duhet të sigurojë se për pozitat e kërkuara do të bëhen planifikimet buxhetore me kohë dhe se NjAB të plotësohet me staf të mjaftueshëm sipas rregullores për themelimin e NjAB.	NjAB ende nuk ishte kompletuar me staf sipas kërkesave ligjore.	Nuk ka filluar zbatimin

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndhmës Auditor i Përgjithshëm



Blerim Kabashi, Drejtor i Auditimit



Enver Boqolli, Udhëheqës i ekipit



Aurora Morina, Anëtare e ekipit



Agim Sogojeva, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Precednika / Office of the Mayor

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Skenderajt , për vitin 2021 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- **pajtohem** / nuk pajtohem/ pajtohem pjesërisht/ me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Fadil Nura
(Kryetar i Komunës)

Data: 14.prill.2022



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁵ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁶, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.